



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 22/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.01.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Marsi & Al” sh.p.k. & “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-82573-08-09-2018, me objekt, “*Blerje këpucë për uniformën e Policisë së Shtetit*” për vitet 2018, 2019 dhe 2020”, me fond limit 290.155,500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 05.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Marsi & Al” sh.p.k. & “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S.
Qendra Blur, Kati i I-rë, Farkë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skënderbej, Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoj relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.08.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-82573-08-09-2018, me objekt, “*Blerje këpucë për uniformën e Policisë së Shtetit*” për vitet 2018, 2019 dhe 2020”, me fond limit 290.155,500 (pa TVSH).

II.2. Në datën 05.10.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi. Referuar verifikimit në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--|-----------------------------------|
| 1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Marsi & Al” sh.p.k. | |
| & “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S. | 269.835.600 lekë, skualifikuar |
| 2. “Sulejman Meta” | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 3. “Muça” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 4. “Paera” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 5. “Donianna” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 16.11.2018, operatori ekonomik ankimes është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

1. *Operatori ekonomik nuk ploteson ne seksionin 2. Kriteret e Vecanta, piken 3.a (Ambientet e prodhimit, në pronësi apo në forma të tjera ligjore të posedimit.) dhe piken 4 (Kopje të librezës së punës) te DT.*
2. *Operatori ekonomik nuk ploteson ne seksionin 2. Kriteret e Vecanta piken 4 (Kopje të librezës së punës) të DT.*
3. *Operatori ekonomik nuk i ka paraqitur te gjitha analizat laboratorike sipas kerkesave ne DT.*
4. *- Bashkimi i Operatoreve ekonomik, konkretisht Operatori ekonomik YDS nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit teknik të DST.*
 - *Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk përmbush nënpikën a) të pikës 3 të kapacitetit teknik kërkohet që ambjentet e prodhimit të jenë në pronësi apo në forma të tjera ligjore të posedimit dhe dokumentacioni të shoqërohet me planimetrinë e fabrikës të ndarë sipas organizimit të biznesit, gjatë verifikimit të dokumentacionit u vëre se Operatori ekonomik YDS, si pjesë e BOE ka sjelle deklarate ne lidhje me ambientet e prodhimit, por nuk ka provuar disponimin apo posedimin e ambienteve te prodhimit sic kerkohet ne DST, ne një nga format e parashikuar ligjore per posedimin, si dhe dokumentacioni nuk eshte i shoqëruar me planimetrine e fabrikes ku të pasqyrohet ndarja dhe organizimi i ambienteve te biznesit. Operatori ekonomike YDS ka sjelle një skemë të prodhimit (jo planimetri) në të cilën nuk janë pasqyruar të gjitha ndarjet e organizimit të biznesit, sic kërkohet në këtë kriter.*
 - *Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk përmbush nënpikën b) dhe b.1) të pikës 3 të kapacitetit teknik, pasi Bashkimi i Operatoreve nuk provon disponimin e të paktën 1 (një) linje prodhimi me makineritë dhe paisjet përkatëse të nevojshme për realizimin e artikujve objekt i kësaj kontrate. Operatori ekonomike ka sjellë deklaratë për disponimin e linjës së prodhimit por nuk provon disponimin me një nga format ligjore, sic kërkohet nga DST.*
 - *Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk përmbush piken 4 te kapacitetit teknik pasi nuk ka paraqitur libreza te stafit teknik.*

II.4. Në datën 21.11.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë ” Marsi & Al” sh.p.k. & “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

[...]

AK ka cilësuar si arsye skualifikimi (2herë):

- *Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk përmbush nënpikën a) të pikës 3 të kapacitetit teknik kërkohet që ambjentet e prodhimit të jenë në pronësi apo në forma të tjera ligjore të posedimit dhe dokumentacioni të shoqërohet me planimetrinë e fabrikës të ndarë sipas organizimit të biznesit, gjatë verifikimit të dokumentacionit u vëre se Operatori ekonomik YDS, si pjesë e BOE ka sjelle deklarate ne lidhje me ambientet e prodhimit, por nuk ka provuar disponimin apo posedimin e ambienteve te prodhimit sic kerkohet ne DST, ne një nga format e parashikuar ligjore per posedimin, si dhe dokumentacioni nuk eshte i shoqëruar me planimetrine e fabrikes ku të pasqyrohet ndarja dhe organizimi i*

ambienteve të biznesit. Operatori ekonomike YDS ka sjelle një skemë të prodhimit (jo planimetri) në të cilën nuk janë pasqyruar të gjitha ndarjet e organizimit të biznesit, sic kërkohet në këtë kriter.

- Operatori ekonomik nuk ploteson në seksionin 2. Kriteret e Vecanta, piken 3.a (Ambientet e prodhimit, në pronësi apo në formë të tjera ligjore të posedimit.)

Pika 3.a e Seksionit 2 në përputhje me shtojcën nr.1 “Për modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit [...] ka përmbajtjen si vijon:

○ **Asetet teknike duhet të përfshijnë:**

a. Ambientet e prodhimit, në pronësi apo në formë të tjera ligjore të posedimit. Dokumenti që duhet të paraqitet nga kompania duhet të jetë i shoqëruar me planimetrinë e fabrikës, të ndarë sipas organizimit të biznesit. Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientet ku do të zhvillojë aktivitetin e tij projektues dhe prodhues ku të përmbajë minimalisht nga 1 (një) nga këto ambiente prodhimi:

- ❑ magazina të lëndës së parë dhe aksesoreve - minimalisht 1 (një)
- ❑ zyra - ambiente projektimi dhe zhvillimi të modeleve - minimalisht 1 (një)
- ❑ repart shtrimi dhe prerjeje - minimalisht 1 (një)
- ❑ repart qepjeje dhe montimi - minimalisht 1 (një)
- ❑ ambiente për paketim dhe ambalazhim - minimalisht 1 (një)
- ❑ magazina të produkteve të gatshme - minimalisht 1 (një)

Në përputhje me këto kritere, BOE ka paraqitur dokumentacionin e disponuar nga subjekti Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S. ku përfshihen:

1. Planimetria e fabrikës:

Planimetria e paraqitur në skedarin “YDS – Plan prodhimi.pdf, dokumenti “Production Floor Plan”, tregon qartazi të gjitha ndarjet e sipërfaqeve sipas organizimit të biznesit. Në praktikën botërore dokumenti i paraqitur quhet “Planimetria e prodhimit” (Production layout) i cili dallon nga “Planimetria arkitekturore” (architectural layout) që me sa duket pretendon KVO-ja që duhet të paraqitet në operatorët ekonomikë.

Meqenëse kërkesa në DST është formuluar si kërkesë e thjeshtë për planimetri dhe jo si planimetri arkitekturore, logjika e punës e do që planimetria e prodhimit shpjegon në mënyrë më të qartë se për AK – në për procesin e biznesit sesa një planimetri arkitekturore e cila nuk tregon funksionalitetet dhe komunikimet midis repartëve të prodhimit.

Në planimetrinë e paraqitur plotësohet kërkesa në DST që planimetria e fabrikës të pasqyrohet të ndarë sipas organizimit të biznesit.

Në planimetri gjenden të gjitha ambientet e kërkuara në DST:

1. Magazine të lëndës së parë dhe aksesore – kutia nr. 121 në planimetri
2. Zyra-ambiente projektimi dhe zhvillimi të modeleve – kutitë 125,126,127,128 në planimetri
3. Repart shtrimi dhe prerjeje – kutitë 139, 140, 141, 142, 143
4. Repart qepjeje dhe montimi – kutitë 144,145,146
5. Ambiente për paketim dhe ambalazhim – kutitë 137,138,147,148
6. Magazine e produkteve të gatshme – kutia 136

2. Deklarata e pronësisë të paktën në ambientet e kërkuara në DST:

Zotëron një sipërfaqe totale prej 65.000 m² e cila i përket prodhimit të këpucëve/cizmeve.

Detajet si më poshtë:

- 20000 m² sipërfaqe e hapur
- 45000 m² sipërfaqe e mbyllur
 - a) Nga totali i 45.000 m², 30.000 është pjesa e prodhimit
 - b) Nga totali i 45.000 m², 15.000 është pjesa e magazinimit

3. Bilanci i shoqërisë provon dhe përforcon titullin e pronësisë së ambienteve të operatorit ekonomik mbi ambientet e prodhimit. Në bilancin e shoqërisë si përcaktohet në DST kun ë asete material, përfshihen zërat:

1. Parcela toke, me vlerë lira turke
2. Ndërtesa me vlerë.....
3. Objekte, makina dhe aparatura me vlerë.....
4. Mjete transporti me vlerë...
5. Inventare me vlerë...
6. Lloje të tjera të aseteve fikse.....
7. Amortizime të akumuluar
8. Investime në process.....

Fakti që zërat e mësipërme, ndodhen të regjistruara në bilancet e shoqërisë qëndron për titullin e pronësisë së shoqërisë mbi këto asete, përndryshme shoqëria nuk mund të kontabilizojë asetet.

4. Në plotësim të dokumentave më sipër, BOE ka paraqitur edhe fotot e fabrikave të cilat demonstrojnë më së mira madhësinë dhe kapacitetet e prodhimit dhe magazinimit të fabrikës. Në këto kushte BOE e plotëson kriterin e pikës 3.a të Seksionit 2 të DST dhe vendimi I AK lidhur me mospërmbushjen e këtij kriteri për këtë pikë, është i paligjshëm dhe I pabazuar.

ANKESË 2

AK ka cilësuar si arsye skualifikimi (tri herë):

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit teknik pasi nuk ka paraqitur librezë të stafit teknik
- Operatori ekonomik nuk plotëson në seksionin 2 Kriteret e veçanta pikën 4 (kopje të librezës së punës) të DT.

Lidhur me pretendimin e ngritur për mospërmbushje të pikës 4 të Seksionit 2 të DST ky pretendim nuk është i bazuar në ligj. Në përputhje me legjislacionin vendas, konkretisht në Republikën e Turqisë, pajisja me librezë pune, nuk është e përcaktuar në ligj, nuk është detyrim ligjor dhe nuk ekziston. Në këto kushte, për plotësimin e këtij kriteri, shoqëria me seli në Turqi, ka paraqitur listëpagesat e personelit për periudhat e kërkuara, ku përfshihen edhe numrat unikë të sigurimeve të cilat në Republikën e Turqisë zyrtarisht janë kusht i nevojshëm dhe I mjaftueshëm për të provuar marrëdhënien e punës, si edhe kodet e punës profesionaleve. Ju sjellim në vëmendjen se edhe në Republikën e Shqipërisë në 2 vitet e fundit në pjesën dërrmuese të prokurimeve publike nuk kërkohet me librezë e punës, dhe listëpagesat e personelit konsiderohen dokumenti zyrtar primar, i sigurtë dhe më autentik për të provuar marrëdhëniet e punës dhe profiling e punës (sipas kodit të profesionit në legjislacion).

Për të hequr çdo lloj shqetësimi apo dyshimi që AK mund të ketë në dokumentat e tenderit është paraqitur deklarata e vetë kompanisë për profesionin e personave të stafit teknik që do të përfshihen në këtë tender.

[...]

Konkludojmë se këto shkresa nuk japin absolutisht më pak informacion se ajo që deklarohet nga punëdhënësi në një librezë pune.

Në këto kushte BOE e plotëson kriterin e pikës 4.a të Seksionit 2 të DST, dhe vendimi i AK lidhur me mospërbushjen e këtij kriteri për këtë pikë është i paligjshëm dhe i pabazuar.

ANKESË 3

AK ka cilësuar si arsye skualifikimi:

OE nuk ka paraqitur të gjitha analizat laboratorike sipas kërkesave të DST.

Në përputhje me këtë kriter të përcaktuar në specifikimet teknike, sipas Aneksit “Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike”, përcaktohet se specifikimet teknike të materialeve duhet të plotësohen nga shoqëria ofertuese. Në përputhje me këtë shoqëria ka plotësuar Aneksin e DST dhe ka paraqitur më tej raportet e testeve, të kryera nga laborator i certifikuar, me anë të të cilit, paraqiten të gjitha materialet dhe rezultatet e testeve përkatëse. Në përfundim të tyre:

- 1. Laboratory ndërkombëtar certifikues Teknoteks i akredituar nga tepër prestigjozja SATRA Accredited Laboratory (accreditation code 06A09) në gjashtë deklaratat e datës 02.10.2018 për secilin nga produktet e tenderit, ka delaruar se materialet e disponuara nga shoqëria janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në prokurimin publik në fjalë.*
- 2. Deklaratat për plotësimin e kriterëve janë shoqëruar me TEST Raport përkatëse numër 57052, 56331, 56330, 56329, 56328, 56326 në të cilat është deklaruar në mënyrë të qartë dhe eksplicite si më poshtë:*

[...]

“Testet janë kryer në lidhje me normat Europiane EN ISO 20344, EN ISO 20347 dhe normat e tjera EN”.

Kjo provon mjaftueshmërisht që të gjitha analizat e kërkuara në tenderi janë kryer me kodet e ISO të kërkuara në tender dhe /ose ekuivalentet e tyre.

Së fundmi AK është shprehur se BOE nuk ka paraqitur të gjitha analizat laboratorike ndërkohë nuk ka cituar as edhe një nga analizat e vetme ndër ato që pretendon se mungojnë. Ndërkohë që BOE ka paraqitur 25 faqe me rezultate testesh laboratorike dhe 6 faqe me konkluzione përmbledhëse. Kjo është një provë shtesë që ekspertët e AK nuk e kanë analizuar dhe vlerësuar me seriozitetin e nevojshëm dhe dokumentacionin e paraqitur nga BOE në tender, dhe për këtë arsye kanë dalë në konkluzione të cekëta dhe të gabuara. Nuk mund të pranohet një akuzë pa paraqitur një provë të vetme për këtë akuzë.

Në këto kushte, BOE e plotëson kriterin e paraqitjes së analizave laboratorike sipas Aneksit të DST dhe vendimi i AK lidhur me mos përbushjen e këtij kriteri për këtë pikë është i paligjshëm dhe i pabazuar.

ANKESË 4

AK ka cilësuar si arsye skualifikimi:

- Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk permbush nënpikën b) dhe b.1) të pikës 3 të kapacitetit teknik, pasi Bashkimi i Operatoreve nuk provon disponimin e të paktën 1 (një) linje prodhimi me makineritë dhe paisjet përkatëse të nevojshme për realizimin e artikujve objekt i kësaj kontrate. Operatori ekonomike ka sjellë deklaratë për disponimin e linjës së prodhimit por nuk provon disponimin me një nga format ligjore, sic kërkohet nga DST. Në DST në nënpikën b) dhe b.1) të pikës 3 të kapacitetit teknik kërkohet: [...]
Pretendimi I AK nuk qëndron pasi të gjitha informacionet dhe dokumentat e kërkuara në këtë pikë janë paraqitur nga BOE. Më konkretisht janë paraqitur:

1. Planimetria e prodhimit të fabrikës ku tregohet qartë edhe linja e prodhimit dhe skema e funksionimit të përbërësve të saj

Planimetria e paraqitur në skedarin “YDS – Plan prodhimi.pdf”, dokumenti “Production Floor Plan” tregon qartazi të gjitha ndarjet e sipërfaqeve sipas organizimit të biznesit.

Në planimetri gjenden të gjitha ambientet e kërkuara në DST

- repart shtrimi dhe prerjeje – kutitë 139,140,141,142,143

- repart qepjeje dhe montimi – kutitë 144,145,146

2. Deklarata e Pronësisë të paktën të ambienteve të kërkuara në DST

Zotëron një sipërfaqe totale prej 65.000 m² e cila i përket prodhimit të këpucëve/cizmeve.

Detajet si më poshtë:

- 20000 m² sipërfaqe e hapur
- 45000 m² sipërfaqe e mbyllur
- c) Nga totali i 45.000 m², 30.000 është pjesa e prodhimit
- d) Nga totali i 45.000 m², 15.000 është pjesa e magazinimit

3. Bilanci i shoqërisë provon dhe përforcon titullin e pronësisë së ambienteve të operatorit ekonomik mbi ambientet e prodhimit. Në bilancin e shoqërisë si përcaktohet në DST kun ë asete material, përfshihen zërat:

1. Parcela toke, me vlerë lira turke
2. Ndërtesa me vlerë.....
3. Objekte, makina dhe aparatura me vlerë.....
4. Mjete transporti me vlerë...
5. Inventare me vlerë...
6. Lloje të tjera të aseteve fikse.....
7. Amortizime të akumuluar
8. Investime në process.....

4. Listat e makinerive të prodhimit është paraqitur e plotë dhe me numrat serialë të tyre në skedarin “YDS – Lista e makinerive pdf”. Kjo linjë prodhimi do të përdoret për të gjithë grupet e artikujve që janë në objektin e tenderit.

Në këto kushte BOE e plotëson nënpikën b) dhe b.1) të pikës 3 të kapacitetit teknik, dhe vendimi I AK lidhur me mospërmbushjen e këtij kriteri për këtë pikë, është i paligjshëm dhe i pabazuar.

Në përputhje me përshkrimin si më sipër, konstatohet se vendimi për refuzimin e ofertës së paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike YDS + Marsi & Al shpk është një vendim i pambështetur në ligj.

[...]

BOE jo vetëm i ka plotësuar kriteret ligjore dhe teknike, por edhe i ka superuar ato.

1) të Akreditimit – IAF.

II.5. Në datën 27.11.2018 nëpërmjet shkresës me nr. 1209/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën, ndërkohë që operatorit ekonomik ankimues sqaron se 06.12.2018.

Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton si më poshtë vijon:

[...]

Pretendon të padrejtë skualifikimin për pikën 3.a. e kapacitetit teknik në kriteret e veçanta të kualifikimit:

3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë zyrtarisht dhe të dokumentojë sipas formave ligjore, të gjitha asetet teknike të prodhimit që do të verë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për prodhimin e këpucëve të uniformës së Policisë së Shtetit. Operatori ekonomik duhet që të garantojë prodhimin në kohë të këpucëve të uniformës, sipas sasisë që do të prokurohen.

Operatori ekonomik duhet që të garantojë prodhimin në kohë të këpucëve, sipas sasisë që do të prokurohen.

○ **Asetet teknike duhet të përfshijnë:**

a. Ambientet e prodhimit, në pronësi apo në forma të tjera ligjore të posedimit. Dokumenti që duhet të paraqitet nga kompania duhet të jetë i shoqëruar me planimetrinë e fabrikës, të ndarë sipas organizimit të biznesit. Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientet ku do të zhvillojë aktivitetin e tij projektues dhe prodhues ku të përmbajë minimalisht nga 1 (një) nga këto ambiente prodhimi:

- ❑ magazina të lëndës së parë dhe aksesorëve - minimalisht 1 (një)
- ❑ zyra - ambiente projektimi dhe zhvillimi të modeleve - minimalisht 1 (një)
- ❑ repart shtrimi dhe prerjeje - minimalisht 1 (një)
- ❑ repart qepjeje dhe montimi - minimalisht 1 (një)
- ❑ ambiente për paketim dhe ambalazhim - minimalisht 1 (një)
- ❑ magazina të produkteve të gatshme - minimalisht 1 (një)

Operatori ekonomik pretendon se ka paraqitur dokumentacionin e disponuar nga subjekti “Yakupoglu tekstil ve deri “SAN TIC.A.A. ku përfshihet:

[...]

Pasi u bë verifikimi i vlerësimit i datës 16.11.2018 në SPE dhe u njoh me procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se për këtë pikë BOE është kualifikuar me shumicë votash nga KVO. Për këtë arsye shqyrtimi në lidhje me këtë pikë është i panevojshëm

2. Pretendon të padrejtë skualifikimin për pikën 4 në seksionin 2 Kriteret e veçanta të DT:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin teknik..... Kopje të librezës së punës”. Operatori ekonomik pretendon se kjo arsye skualifikimi nuk është bazuar në ligj, sepse në përputhje me legjislacionin e Republikës së Turqisë pajisja me librezë pune nuk është përcaktuar në ligj, nuk ka detyrim ligjor dhe nuk ekziston.

Për këtë arsye është paraqitur listëpagesa ku janë dhe numrat unikë të sigurimeve që në Republikën e Turqisë janë kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të provuar marrëdhënien e punës. Gjithashtu është paraqitur edhe deklarata e vetë kompanisë për profesionin e personave teknik që do të përfshihen në këtë tender.

Pasi u bë verifikimi i DST dhe dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria ku konstaton se nga operatori “Yakupoglu tekstil ve deri “SAN TIC.A.A. nuk janë dorëzuar librezat e punës për stafin teknik ashtu si kërkohet në DST. Këto librezat janë konsideruar të nevojshme për tu paraqitur pasi dëshmojnë për eksperiencën e stafit teknik i cili do të zbatojnë këtë objekt prokurimi. Për këtë arsye BOE duhet të kishte paraqitur librezat e punës i cili tregon vitet e punës dhe pozicionin e punës që ky personel ka punuar. Gjithashtu theksojmë se në rast se nga shoqëria juaj është gjykuar si i panevojshëm ky kriter, ju duhet të kishit paraqitur ankesë në lidhje me këtë pikë brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, bazuar kjo në nenin 63 të LPP[...], si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 78 pika 4 ku përcaktohet [...].

Për arsyet e mësipërme skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë për këtë pikë është i drejtë dhe pretendimi i BOE nuk pranohet.

3. Pretendon për skualifikim për “ANEKS – Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike [..]

Operatori ekonomik pretendon se matarialet e disponuara nga shoqëria janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në procedurën në fjalë. Testet janë kryer në lidhje me normat Europiane EN ISO [..].

Pasi u bë verifikimi i vlerësimit i datës 16.11.2018 në SPE dhe u njoh me procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se për këtë pikë BOE është kualifikuar me shumicë votash nga KVO. Për këtë arsye shqyrtimi në lidhje me këtë pikë është i panevojshëm

4. Pretendon të padrejtë skualifikimin për pikën 3.b. kapaciteti teknik në kriteret e vecanta të kualifikimit: [...]

Operatori pretendon se kjo pikë nuk qëndron pasitë gjitha informacionet dhe dokumentat e kërkuara në këtë pikë janë paraqitur: [...]

Pasi u bë verifikimi i vlerësimit i datës 16.11.2018 në SPE dhe u njoh me procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se për këtë pikë BOE është kualifikuar me shumicë votash nga KVO. Për këtë arsye shqyrtimi në lidhje me këtë pikë është i panevojshëm

II.6. Në datën 11.12.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

Konkrektisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:
[...]

Ankesa e BOE është ndarë në katër pika duke kundërshtuar katër arsyet e skualifikimit që BOE gjeti në vendimin e KVO në faqen e app. Në përgjigjen e AK për pika 1, 3 dhe 4 të ankesës së BOE është shpjeguar apo vendosur në mënyrë implicite që pretendimi i BOE qëndron dhe ato nuk mund të jenë shkak për skualifikimin e ofertës. Arsyeja e dhënë nga AK është e njëjtë për të treja pikat[...].

Në lidhje me pikën 2 të ankesës AK ka argumentuar që vendimi i KVO-së është i drejtë duke lënë në fuqi vendimin e skualifikimit të ofertës ekonomike nga BOE.

Argumenimi i AK nuk qëndron:

Sikurse e thotë vetë AK-ja qëllimi që librezat e punës janë konsideruar të nevojshme për tu paraqitur janë dëshmojnë për eksperiencën e stafit teknik i cili do të zbatojnë këtë objekt prokurimi. Dëshmia që kërkon AK-ja merret fare qartë nga listëpagesat e personelit për periudhat e kërkuara ku përfshihen edhe numrat unikë të sigurimeve të cilat në Republikën e Turqisë zyrtarisht janë kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të provuar marrëdhënien e punës si edhe kodet e punës profesionaleve. Listëpagesat kanë informacion më të plotë dhe të saktë për kohën dhe pozicionin e punës së çdo lloji dokumenti tjetër zyrtar që ekziston, janë dokumentme vlerë më të lartë juridike se librezat e punës, se pikërisht për këto dy arsye është dokumenti që kërkohet kudo dhe në çdo tender. Për të hequr çdo lloj shqetësimi apo dyshimi që AK mund të kishte, në ofertën e BOE është paraqitur deklarata e vetë kompanisë për profesionin e personave të stafit teknik që do të përfshihen në këtë tender.

Në përputhje me legjislacionin në Republikën e Turqisë pajisja me libreza pune nuk është detyrim ligjor dhe për shumicën e punëdhënësve turk as që ekziston fare. Bashkëngjitur do të gjeni një deklaratë të shoqërisë turke pjesëmarrëse në BOE ku vërteton që në zbatim të ligjit të punës së Turqisë (ligji nr. 4857) as nuk mban dhe as ka detyrim ligjor ti mbaj librezat e punës për punonjësit e saj.

Legjislacioni i prokurimeve publike në Shqipëri (përfshi këtu edhe udhëzimet e APP) për operatorët e huaj ekonomikë kërkon që si dokumenta tenderi të kërkuara në prokurimet publike të sjellin dokumenta ekuivalente në vendet e tyre kur ko kërkesë zbatohet, ose asnjë dokument kur kërkesa është e pazbatueshme. Pikërisht këtë ka bërë dhe partneri turk në BOE ka sjell dokument ekuivalent në Republikën e Turqisë së siguron informacionin e kërkuar nga Ak në DST.

Me llogjikën e AK BOE duhet të ishte skualifikuar edhe sepse nuk ka paraqitur vërtetimin e pagesës së energjisë elektrike që kërkohet në kriteret e kualifikimit të tenderave publik në Shqipëri.

Në epokën e digjitalizimit librezat e punës po bëhet një dokument obsolet në të gjitha vendet dhe në pjesën dërrmuese të vendeve të BE-së nuk ekziston më fare. Me interpretimin e gabuar që i bën LPP-së AK-ja i bie që nuk duhet të lejojë asnjë operator ekonomik nga vendet e BE-së që të mari pjesë në tenderat publikë të Republikës së Shqipërisë, dhe vetëm kjo mjafton të provojë që interpretimi i ligjit nga AK është krye e këput gabim.

Në vazhdim të logjikës së mësipërme konstatojmë që edhe në prokurimet publike në Shqipëri në 2-3 vitet e fundit po zhduket nga qarkullimi kërkesa për paraqitjen e librezave të punës.

AK-ja pretendon që BOE duhet të kishte bërë ankesë në bazë të LPP për dokumentacionin e tenderit për të kërkuar heqjen e këtij kriteri përpara datës së tenderit nëse kishte bindjen që ishte një kërkesë e panevojshme.

Përsëri AK gabon në interpretimin e LPP-së. BOE nuk e konsideron kërkesën për librezat pune si kërkesë të pabazuar në ligj dhe të panevojshme. Në rrethanat e ngjarjes ajo edhe mund të ishte (jetë) e nevojshme për AK-në dhe është kërkesë brenda ligjit, për të vlerësuar kapacitetin teknik të operatorëve ekonomikë shqiptar por është e panevojshme dhe e pamundur për shumicën dërrmuese të operatorëve ekonomikë të huaj që kanë të drejtë të marrin pjesë në prokurim. Legjislacioni i prokurimeve publike sikurse nuk lejon diskriminimin negativ për një palë, nuk lejon as atë pozitiv për një palë. Heqja e kësaj kërkesë nga dokumentat e tenderit, do të ulte cilësinë e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës vendas.

Zgjidhja sikurse argumentuam më sipër qëndron pikërisht tek lejimi i dokumentacionit përkatës në shtetin përkatës të operatorëve ekonomik të huaj pjesëmarrës në tender.

II.7. Në datën 24.12.2018 nëpërmjet shkresës me nr. 1322/1 prot., datë 21.12.2018, me objekt *“Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje këpucë për uniformën e Policisë së Shtetit” për vitet 2018, 2019, 2020”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Marsi & Al” sh.p.k. & “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionit dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Marsi & Al” sh.p.k. & “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S., se arsyeja e skualifikimit se: *“Operatori ekonomik nuk ploteson ne seksionin 2. Kriteret e Vecanta piken 4 (Kopje të librezës së punës) të DT”*, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 4, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

- 4. *Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik specialistë të fushës me eksperience pune minimalisht 3 vjeçare në pozicionet e punës si :*
 - *inxhinier kimist, të paktën një punonjës*
 - *specialist të lëkurës dhe këpucëve, të paktën një punonjës*
 - *modelist, të paktën një punonjës*
 - *përgjegjës prodhimi/linje, të paktën një punonjës*
 - *prestarë, të paktën një punonjës*
 - *kontrollorë cilësie, të paktën një punonjës*

Këta punonjës duhet të jenë pjesë e stafit të operatorit ekonomik.

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin teknik,*
 - *një listë të personelit kryesor teknik të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.*
 - *CV.*
 - *Kopje të diplomave apo të dëshmive të aftësive profesionale nëse i zotërojnë. Në mungesë të një diplome/certifikate, do të merret parasysh kualifikimi për shkak të eksperiencës. Punonjësi duhet të ketë eksperiencë minimale tre vjeçare në llojin e profesionit të kërkuar, në fushën përkatëse.*
 - *Kopje të librezës së punës.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ Marsi & Al” sh.p.k. & “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S. rezulton se, është paraqitur dokumenti Akt Marrëveshje për bashkim të përkohshëm të shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” Sanayi Ticaret Anonim Sirketi” sh.p.k. dhe shoqërisë ”Marsi & Al” sh.p.k., nga ku shoqëria “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” Sanayi Ticaret Anonim Sirketi” ka marrë përsipër të kryejë 86% të volumit të punëve

dhe konkretisht merr përsipër kryerjen e prodhimit të artikujve që janë në listën e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe shoqëria "Marsi & Al" sh.p.k. ka marrë përsipër të kryejë 14% të volumit të punëve dhe konkretisht merr përsipër: dërgimin e porosive sipas kontratës tek kompania "Yakupoglu Tekstil Ve Deri" Sanayi Ticaret Anonim Sirketi"; organizimin e transportit nga prodhuesi deri në destinacionin e kërkuar; pritjen e mallit nën doganë duke kryer të gjitha pagesat e detyrimeve në territorin shqiptar; kontrollimin, kolaudimin e mallit dhe magazinimin e tij; marrjen e analizave nga një laborator i certifikuar dhe krahasimin e tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor; shpërndarjen e artikujve në destinacionet e caktuara nga Enti Prokurues; sigurimin e koordinimit midis autoritetit kontraktor dhe prodhuesit.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të kriterit të mësipërm konstatohet se nuk është paraqitur dokumentacion në lidhje me librezat e punës së punonjësve.

III.1.4. Operatori ekonomik ankimues pretendon ndërmjet të tjerave se: *"Lidhur me pretendimin e ngritur për mospërmbushje të pikës 4 të Seksionit 2 të DST ky pretendim nuk është i bazuar në ligj. Në përputhje me legjislacionin vendas, konkretisht në Republikën e Turqisë, pajisja me librezë pune, nuk është e përcaktuar në ligj, nuk është detyrim ligjor dhe nuk ekziston. Në këto kushte, për plotësimin e këtij kriteri, shoqëria me seli në Turqi, ka paraqitur listëpagesat e personelit për periudhat e kërkuara, ku përfshihen edhe numrat unikë të sigurimeve të cilat në Republikën e Turqisë zyrtarisht janë kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të provuar marrëdhënien e punës, si edhe kodet e punës profesionaleve. Ju sjellim në vëmendjen se edhe në Republikën e Shqipërisë në 2 vitet e fundit në pjesën dërrmuese të prokurimeve publike nuk kërkohet me librezë e punës, dhe listëpagesat e personelit konsiderohen dokumenti zyrtar primar, i sigurtë dhe më autentik për të provuar marrëdhëniet e punës dhe profiling e punës (sipas kodit të profesionit në legjislacion)".*

III.1.5. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se: *"Pasi u bë verifikimi i DST dhe dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria ku konstaton se nga operatori "Yakupoglu tekstil ve deri "SAN TIC.A.A. nuk janë dorëzuar librezat e punës për stafin teknik ashtu si kërkohet në DST. Këto librezë janë konsideruar të nevojshme për tu paraqitur pasi dëshmojnë për eksperiencën e stafit teknik i cili do të zbatojnë këtë objekt prokurimi. Për këtë arsye BOE duhet të kishte paraqitur librezat e punës i cili tregon vitet e punës dhe pozicionin e punës që ky personel ka punuar. Gjithashtu theksojmë se në rast se nga shoqëria juaj është gjykuar si i panevojshëm ky kriter, ju duhet të kishit paraqitur ankesë në lidhje me këtë pikë brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, bazuar kjo në nenin 63 të LPP[...], si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 78 pika 4 ku përcaktohet [...]"*.

III.1.6. Në dokumentacionin dhe informacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, ky i fundit ka bërë verifikimet përkatëse pranë Ambasadës së Turqisë në Shqipëri, duke shtruar pyetjen *"Nëse në shtetin turk të punësuarit (punëmarrësit) pajisen me librezë pune nga punëdhënësit. Nëse po, cili është formati/një model librezë pune."*

Nëse në shtetin turk ekziston ndonjë dokument ekuivalent me librezën e punës që pajisen punonjësit në shtetin shqiptar, dokument i cili vërteton vitet e punës".

Në kthimin e përgjigjes së saj, Ambasada Turke përgjigjet (citojmë): *"Çertifikata e punës (Librezë e punës) është një dokument që lëshohet nga punëdhënësi për punëmarrësin i cili largohet nga puna për çdo lloj arsye dhe që përmban informacione për kohën e punës, llojin e punës etj.*

Në nenin 28 të titulluar "Çertifikata e punës", në Kodin Turk të Punës thuhet: "Punëmarrësit që largohet nga puna, Punëdhënsi i jep një dokument ku shkruhet lloji i punës dhe vitet në atë punë të Punëmarrësit."

Punëmarrësi që dëmtohet nga mosdhënia në kohë e Çertifikatës dhe nga mungesa e të dhënave të sakta në çertifikatë mund të kërkojë dëmshpërblim. Lëshimi i Çertifikatës nuk i nënshtrohet ndonjë takse ose taimi”.

III.1.7. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”*

III.1.8. Në nenin 27 “Kontratat e shërbimeve”, pika 5, e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën[...].”*

III.1.9. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtui, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.*

Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi... ”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.10. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.1.11. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një ndër parimet kryesore të përzgjedhjes referuar edhe nenit 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, është edhe mosdiskriminimi dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.1.13. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt shqyrtimi, gjë, e cila nuk vërtetohet me dokumentacionin e paraqitur, pasi konstatohet mungesë fizike dokumentacioni nga ana e operatorit ekonomik ankimues, për librezat e punës, të cilat nuk janë paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike për këtë procedurë prokurimi.

Me dokumentacionin e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk vërtetohet fakti në lidhje me disponimin e stafit teknik për eksperiencën minimalisht 3 vjeçare, pasi sqarojmë se plotësimi i këtij kriteri nëpërmjet të gjithë dokumentacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, është lidhur në tërësinë e tij dhe duhet parë i plotë për përmbushjen e tij, pasi nëpërmjet librezave të punës bëhet e mundur të verifikohet fakti i eksperiencës 3 vjeçaree.

III.1.14. Akoma më tej, nga verifikimet e kryera nga ana e vetë autoritetit kontraktor pranë Ambasadës Turke në Shqipëri, e cila është përfaqësuese e shtetit Turk, sqaron më së miri se, ekziston një dokument i tillë, që titullohet Çertifika e punës (Libreza e punës), në të cilën, evidentohet fakti i eksperiencës së punës së një punëmarrësi. Sqarojmë se, operatori ekonomik ankimues duhet të kishte përmbushur kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për më tepër në kushtet kur, ky dokument (libreza e punës) është një dokument lehtësisht i disponueshëm, pasi është një shprehje vullneti nga ana e Punëdhënësit duke plotësuar të dhënat e punëmarrësit në të. Pra, sa më sipër, një dokument i tillë ekziston në shtetin Turk, dhe për sa kohë që ekziston një dokument i tillë ai detyrimisht duhet të ishte përmbushur nga ana e ankimusit.

Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

III.1.15. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për paraqitjen e deklaratës bashkëlidhur ankesës së depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqarojmë se, nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se, ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor, pasi, dokumentacione shtesë, të cilat ndikojnë në

vlerësimin e një operatori ekonomik në një procedurë prokurimi, të cilat rrjedhimisht çojnë në ndërhyrjen në ofertë, nuk mund të konsiderohen si të vlefshme, sepse nuk mund të lejohet apo pranohet asnjë dokumentacion pas hapjes së ofertave dhe që nuk është depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike përpara datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë, për më tepër, që përveç faktit që kjo deklaratë duhet të paraqitet në sistemin e prokurimeve elektronike, është e pavlefshme edhe për vetë brendinë e saj, në kushtet kur nga përfaqësia diplomatike e shtetit Turk në Tiranë, deklarohet ekzistenca e një dokumenti të tillë.

III.1.16. KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

III.1.17. Sa më sipër, KPP gjykon se, operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur, referuar konstatimeve të mësipërme, nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nuk janë paraqitur librezat e punës së stafit teknik, kriter ky i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, duke mbetur i skualifikuar nga procedura në fjalë, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Marsi & Al” sh.p.k. & “Yakupoglu Tekstil Ve Deri” San.Tic.A.S” sh.p.k., për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me nr. REF-82573-08-09-2018, me objekt, *“Blerje këpucë për uniformën e Policisë së Shtetit” për vitet 2018, 2019 dhe 2020*, me fond limit 290.155,500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 05.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. Protokoli 1857

Datë 11.12.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha